

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit
Titulli i lëndës:	Praktika pedagogjike II
Niveli:	Master – Mësimdhënie e Kimisë
Statusi i lëndës:	E obliguar
Viti i studimeve:	II (Semestri III)
Numri i orëve në javë:	3+0
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	E martë 16:45 – 19:00
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Arlinda Bytyqi – Damoni
Detajet kontaktuese:	arlinda.damoni@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Kursi Praktika Pedagogjike II, ka dy komponente përbërëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mësimin praktik në Fakultet – përgatitjen teorike ku përfshihet thellimi dhe përforsimi i njohurive mbi standardet dhe kërkesat e kurrikulës së re kosovare 2. Mësimin praktik në shkolla – përgatitjen praktike në nivelin e shkollës së mesme të ulët dhe/ose të lartë <p>Të dy komponentët bashkarisht synojnë zhvillimin profesional të mësimdhënësve të ardhshëm të matematikës në kuadër të shkollës së mesme të ulët dhe/ose të lartë.</p>
Qëllimi i lëndës	Gjatë praktikës pedagogjike II, studentët do të zgjerojnë njohuritë për praktikën mësimore dhe për procesin e zhvillimit të aktiviteteve në klasë. Qëllimi parësor i kursit është zhvillimi i shkathtësive për planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies efektive në klasë, përfshirë edhe vlerësimin e nxënësve, si dhe të kuptuarit e rolit dhe përgjegjësisë së mësimdhënësve brenda shkollës dhe klasës.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Paraqesin ide rreth motivimit dhe organizimit të aktiviteteve në klasë • Përdorin burime teknologjike për mësimdhënien e matematikës • Shqyrtojnë kërkesat kurrikulare rreth planifikimit të mësimdhënies • Analizojnë kërkesat kurrikulare rreth vlerësimit si pjesë integrale e mësimdhënies • Vlerësojnë përdorimin e burimeve dhe mjeteve të shumëllojshme mësimore për realizimin e mësimdhënies

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	6	18
Ushtrime teorike/laboratorike	3	5	15
Punë praktike	5	10	50
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare			
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgaditja përfundimtare për provim	2	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet etj	1	2	2
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:			
	Ligjërata interaktive Punë në grupe Praktikë në shkollë Reflektime ne fakultet		
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Vijimi i rregullt 20 % • Portfolio 20 % • Ditari reflektiv i studentit 20 % • Vlerësimi përfundimtar 40 % 		
Literatura:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Edukimit. (2017) Doracaku për mësimin praktik. 2. MASHT (2017). Korniza e Kurrikulës së Kosovës 3. MASHT (2017) Kurrikulat bërthamë për arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë 		

Plani i detajuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Përshkrimi i kursit/ Rëndësia e ndërlidhjes së teorisë me praktikën mësimore 17 Shtator 2024
Java e dytë:	KKK dhe Kurrikulat bërthamë 24 Shtator 2024
Java e tretë:	Kuptimi dhe funksioni i rezultateve të të nxënit Literatura: Udhëzues praktik për zbatimin e kurrikulës (Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës) 1 tetor 2024
Java e katërt:	Aspektet metodologjike dhe praktike të planifikimit të mësimit Literatura: Udhëzues praktik për zbatimin e kurrikulës 8 Tetor 2024
Java e pestë:	Metodologjia e mësimdhënies, Organizimi i klasës, materialet e nevojshme 15 Tetor 2024
Java e gjashtë:	Vlerësimi 22 Tetor 2024
Java e shtatë:	Mësim praktik në shkollë 29 Tetor 2024
Java e tetë:	Mësim praktik në shkollë 5 Nëntor 2024
Java e nëntë:	Mësim praktik në shkollë 12 Nëntor 2024
Java e dhjetë:	Mësim praktik në shkollë 19 Nëntor 2024
Java e njëmbëdhjetë:	Reflektime mbi orët mësimore - fokusimi tek rezultatet e të nxënit 26 Nëntor 2024
Java e dymbëdhjetë:	Reflektime mbi orët mësimore - fokusimi tek planifikimi 3 Dhjetor 2024
Java e trembëdhjetë:	Reflektime mbi orët mësimore - fokusimi tek metodat /teknikat e mësimdhënies, organizimi i klasës dhe vlerësimi 10 Dhjetor 2024
Java e katërbëdhjetë:	Prezantimi i portfoliove- minikonference 17 Dhjetor 2024
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezantimi i portfoliove- minikonference 24 Janar 2024

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes

- *Studentët janë të obliguar të përcjellin ligjëratat dhe të kryejnë detyrat praktike. Nëse studenti mungon për tri javë nuk i nënshtrohet vlerësimit dhe detyrohet ta rindëgjoj përsëri lëndën në vitin vijues.*
- *Të gjitha obligimet, por edhe pjesëmarrja në ligjëratat dhe ushtrime janë pjesë e vlerësimit përfundimtar. Gjithashtu edhe studentët që janë në marrëdhënie pune në arsim janë të obliguar t'i ndjekin ligjëratat.*
- *Studenti është i obliguar të bëj prezentimin në kohën e caktuar nga mësimdhënësi. Mungesa në ditën e prezentimit nuk mund të kompensohet.*
- *Detyrat dorezohen deri në ora 00:00 te datës së caktuar nga mësimdhënësi. Detyrat e dorëzuara pas kësaj kohe nuk merren në konsideratë.*
- *Studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe të marrin pjesë në çdo aktivitetet.*
- *Gjatë orëve mësimore dhe provimeve nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë. Fotografimi apo inçizimi pa leje në orë është i ndaluar me rregullore të UP.*
- *Nuk lejohet ardhja me vonesë apo largimi nga ora pa arsye. Arsyetimet për mungesë përmes emailit nuk merren parasysh.*